



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.¹⁴..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 22/ 01 / 2024

VENDIM

Nr. 04, datë 22/01/2023

PËR

**PËRCAKTIMIN E DIGAVE TË MËDHA ME PRIORITET NË PËRDORIMIN E FONDIT PËR
PROGRAMIN E EMERGJENCAVE CIVILE TË MINISTRISË SË MBROJTJES
PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE QË LIDHEN ME DIGAT**

Bazuar në Ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", Ligjit Nr. 97/2023, datë 07.12.2023 "Për Buxhetin e vitit 2024" si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 22.01.2024 mori në shqyrtim kërkesën e AKMC për bashkëpunim në lidhje me përdorimin e fondit për programin e emergjencave civile të Ministrisë së Mbrojtjes për financimin e projekteve që lidhen me digat të parashikuar në nenin 15, pika 8 e ligjit Nr. 97/2023, datë 07.12.2022. Bazuar në ligjin e mësipërm, Ministria e Mbrojtjes përmes një Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore (KPMFN) të kryesuar nga Drejtori i AKMC është ngarkuar të miratoj specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve për rehabilitimin dhe rikonstruksionin e digave dhe rezervuarave si dhe vlerësimin e projekteve. Në kuadër të këtij programi është parashikuar përdorimi i një fondi të vecantë për digat në vlerën prej 500 milion lekë.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

1. Ti kërkoj Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore (KPMFN) pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) që në vlerësimin e kriterëve për financimin e projekteve për rehabilitimin dhe rikonstruksionin e digave dhe rezervuarave **të kenë prioritet digat e mëdha dhe rezervuarat e tyre me rrisht të lartë për zonat urbane poshtë tyre të dhëna në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.** Kjo tabelë është përgatitur duke marrë në konsideratë 4 kriteret kryesore të përcaktimit të rrishtit të dhëna nga ICOLD sic janë; numri i njerëzve në rrisht që ndodhen poshtë digës, dëmet ekonomike që shkaktohen në zonat poshtë digave si rezultat i shfrytëzimit të digës, volumi i ujit në rezervuar dhe lartësia e digës;
2. Ti kërkoj KPMFN që **projektet e përzgjedhura të kenë të përfshirë sistemet e alarmit në digë dhe në zonat urbane poshtë tyre të rrezikuara nga shfrytëzimi i digave dhe rezervuarave si dhe sistemet e monitorimit në digat të kërkuara në VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", neni 32, pika 2 dhe neni 35;**
3. Ti kërkoj KPMFN që dokumentacioni teknik i projekteve të përgatitura nga konsulentë të licencuar për projektimin e digave të caktuar nga shfrytëzuesit e digave sipas njësive të veteqeverisjes vendore aplikuese të miratohen nga KKDM përpara se të filloj zbatimi i projektit sipas kërkesës së aneksit 7 të ligjit përkatës Nr. 97/2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

4. Të informoj shfrytëzuesit e digave të mëdha për të aplikuar në Fondin për digat për vitin buxhetor 2024 duke patur si prioritet digat e mëdha me rrishtim me të lartë për njerëzit që banojnë poshtë tyre dhe të përfshijnë në projektet për rikonstrukcionin e digave dhe rezervuarave të financuara nga Fondi për digat, Instalimin e sistemeve të alarmit dhe të sistemeve të monitorimit të digave sipas kërkesave të VKM së mësisipërme, neni 32 dhe neni 35. Gjithashtu, pjesë e këtyre projekteve duhet të jenë edhe përgatitja e planeve të gadishmerisë për emergjencat civile në rastet e prishjes së mundshme të digave apo prurjeve me përsëritje një herë në 100 vjet dhe 1 herë në 1000 vjet të cilat duhet të kenë të përfshira hartat përkatëse të përmbytjes së zonave poshtë digave, llogaritjet e valës vërshuese dhe kurbat e volumeve dhe të sipërfaqeve të ujit në rezervuar sipas udhëzime të dhëna nga KKDM përmes Vendimeve të mëparshme përkatëse.
5. Të caktoj znj. Rolanda Hila/Antare e KKDM si koordinatore dhe përfaqësuese e KKDM në procesin e bashkëpunimit ndërmjet AKMC dhe KKDM të kërkuar ëe pikën 4 të aneksit 7 të ligjit në fjalë.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

